



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Analizë Teksti

Ngarkesa: 8 kredite (= 80 orë)

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi Bachelor me profilin “Përkthim dhe Interpretim në Gjuhët Greke dhe Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TËNXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive komunikuese në gjuhën angleze në katër fushat: dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim. Pasurimi i fjalorit dhe përvetësimi i strukturave gramatikore për të përmirësuar aftësinë shprehëse të studentëve. Nxitja e autonomisë së të nxëniet dhe përmirësimi i strategjive personale të mësimit të gjuhës përmes aktiviteteve ndërvepruese.

Objektivat specifike lëndore:

1. Zhvillimi i aftësisë për të kuptuar dhe analizuar tekste të ndryshme përmes teknikave si skimming, scanning dhe hamendësimi nga konteksti.
2. Përmirësimi i aftësive të dëgjimit dhe të shkruarit, përfshirë planifikimin, rishikimin dhe parafrazimin.
3. Konsolidimi i fjalorit përmes përdorimit të sinonimeve, antonimeve, shprehjeve frazeologjike dhe formimit të fjalëve.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë tekste autentike nga fusha të ndryshme, duke identifikuar idetë kryesore dhe informacionin specifik.
2. Do të jenë në gjendje të shkruajnë tekste të qarta dhe të strukturuar (letra, ese, përmbledhje), duke respektuar rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.
3. Do të komunikojnë me saktësi dhe rrjedhshmëri në situata të ndryshme të jetës së përditshme dhe akademike, duke shprehur mendime dhe duke ndërvepruar me bashkëbisedues vendas.